



Prishtinë: 24.09.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1044_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1848_08_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **13.09.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 24.09.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin L. D. , nga fshati Raskovë, Kastriot, me shifër të konsumatorit: DPR - 90065784, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1848_08_18 i datës 22.08.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 13.09.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se korrigjimi i KESCO-s është i saktë, pasi që njehsori elektrik ka regjistruar vetëm 33.33% ndërsa 66.66% nuk ka regjistruar fare. Në ankesë është theksuar se pasaktësia në matjen e njehsorit elektrik nuk është trajtuar në asnjë mënyrë nga KESCO, si keqërdorim. Në ankesë theksohet se organi i shkallës së parë vendimin e mbështet në rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe se thekson se dallimi i shpenzimit nuk përputhet me korrigjimin e bërë prej 66.66%. Në ankesë theksohet se punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë theksuar se njehsori ka të djegur sistemin R dhe T dhe se për këtë çështje njehsori ka regjistruar shpenzim për 66.66% më pak, dhe se ky konstatim është provë e mjaftueshme. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1848_08_18 i datës 22.08.2018 për konsumatorin Lindita Daka me shifër DPR – 90065784.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se korrigjimi i KESCO-s është i saktë, pasi që njehsori elektrik ka regjistruar vetëm 33.33% ndërsa 66.66% nuk ka regjistruar fare, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë shqyrtimit të lëndëve të konsumatorit nuk mund të merret për bazë vetëm procesverbalin e kalibrit dhe të theksohet se ajo është provë meritore dhe pa bërë asnjë analizë tjetër të shkresave tjera. Bordi i ZRRE-së thekson se KESCO në ankesë ka theksuar punëtorët e qendrës së kalibrit kanë theksuar se njehsori ka të djegur sistemin R dhe T dhe se për këtë çështje njehsori ka regjistruar shpenzim për 66.66% më pak, mirëpo në procesverbalin e ndërrimit dhe heqjes së njehsorit elektrik nr.0657261 të datës 15.06.2017 nuk është evidentuar që njehsori ka çfarëdo dëmtimi përfshi edhe me sistemet matëse.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se organi i shkallës së parë vendimin e mbështet në rrjedhën e energjisë elektrike aktive, Bordi i ZRRE-së thekson se analizimi i shpenzimeve të energjisë elektrike është indikator mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e lëndëve të konsumatorëve. Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike aktive të konsumatorit dhe se bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstaton se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike. Për këtë është bërë analizimi i shpenzimeve të energjisë elektrike të konsumatorit për periudhën kontestuese, me periudhat e njëjta të më hershme dhe të mëvonshme me dy njehsorët elektrik, njehsorin kontestues nr.93145335 si dhe njehsorin e ri elektrik nr. 67786795, dhe vërteton se konsumatori ka ndryshim të vogël në shpenzimin e energjisë elektrike, por që ky ndryshim nuk përputhet me korrigjimin plotësues prej 66% faturuar nga KESCO. Duhet theksuar se shpenzimi i konsumatorit për periudhat e më hershme me njehsorin elektrik nr.93145335 është: periudha 12/2013 deri në periudhën 05/2014 është **735 kWh/muaj**, periudha 12/2014 deri në periudhën 05/2015 është **584 kWh/muaj**, periudha 12/2015 deri në periudhën 05/2016 është **416 kWh/muaj**, periudha 12/2016 deri në periudhën 05/2017 është **452 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.67786795: periudha 12/2017 deri në periudhën **05/2018** është **613 kWh/muaj**. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në analizat e bëra rrjedhës së energjisë elektrike, si dhe të gjeturave në procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr.35/26 të datës 26.07.2017 konstaton se konsumatori në periudha të ndryshme kohore ka luhatje të shpenzimit të energjisë elektrike, por që ngarkesa plotësuese prej 66.66% nuk përputhet me shpenzimet e konsumatorit në asnjë periudhë kohore, e për të cilën përqindje KESCO ka konstatuar se njehsori elektrik nuk ka bërë regjistrimin e energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE ka shqyrtuar korrigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO nr.90934DPR-90065784 në vlerë financiare 367.40€ për faturat e periudhës 12/2016 deri më 05/2017, dhe konstaton se korrigjimi plotësues i faturuar duke marr për bazë edhe konsumin e konsumatorit nga fillimi me njehsorin elektrik nr.93145335 përfshi edhe konsumin me njehsorin e ri elektrik nr.67786795 nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit, dhe si rrjedhojë konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë ku është kërkuar që konsumatori të lirohet nga korrigjimi plotësues nr.90934DPR-90065784 i datës 11.08.2017 në vlerë 367.40€ është vendim i drejtë, i bazuar në fakte, si dhe i bazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit primar dhe sekondar të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithshme pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit L. D. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.